



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Z. ERION PANO

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 Vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 13.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit Erion Pano, i cili aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Erion Pano ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2005, pasi me dekretin nr. Nr. 4558, datë 05.05.2005 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Më parë Z.Pano ka ushtruar funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore. Nga dosja personale rezulton se nuk ka patur transferime si dhe ka patur pozicionin Zv/Drejtuesi Prokurorie në Tiranë. Ai ka një eksperiencë profesionale në punë për afro 15 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë i komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.2642/1 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë rezulton se KLP-së i është bërë me dije ngarkesa aktuale dhe ajo gjatë vitit 2019 i të tre kandidaturave në një kuadër të përgjithshëm, ku trajtohet përveç ngarkesës së tyre edhe problematikat e ardhura nga largimet e prokurorëve të kësaj prokurorie. Në fund të kësaj shkrese Drejtuesja e lë në dorë të Këshillit gjetjen e modaliteteve për komandimin ose jo të tyre duke mos cënuar punën e prokurorisë në kushtet aktuale.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës pasi vlerësoi opinionin e drejtueses dhe ngarkesën respektive të kandidatëve, vlerëson se komandimi i z. Erion Pano si Këshilltar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili ka ngarkesën me të uëet në punë, nuk passjell cënim të interesave të larta të Prokurorisë Tiranë dhe nuk cënon funksionalitetin e saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Erion Pano.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020